



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA DRAGASH

Numri i lëndës: 2022:078250

Datë: 04.12.2024

Numri i dokumentit: 02930749

P.nr.24/22

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA NË DRAGASH, DIVIZIONI PENAL, gjyqtarja e vetme gjykuese Sabaheta Kurteshi, me bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në lëndën penale kundër të pandehurit S. R. nga fshati..., Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale, Sulmi nga neni 184 par.2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (KPRK)-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr. 551-1/22 të datës 19.04.2022, jashtë seancës gjyqësore, me datë 04.12.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HUDHET poshtë aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.551-1/22 e datës 19.04.2022 dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurit S. R. nga fshati..., Komuna e Dragashit, i lindur me datë..., nga babai R. dhe e ëma Xh., për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par. 2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Kosovës - *për shkak të vdekjes së të pandehurit*.

II. Pala e dëmtuar: S. (E.) R. nga fshati..., Komuna e Dragashit, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

III. Shpenzimet procedurale bien në llogari të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.551-1/22 të datës 19.04.2022, kundër të pandehurit S. R. nga fshati..., Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale, sulmi nga neni 184 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 18.04.2024, mirëpo në seancë nuk është paraqitur i pandehuri S. R., e në fletëkthesë është konstatuar se pala ka vdekur.

Gjykata me datë 17.04.2024 i është drejtuar me parashtrësë Zyrës së Gjendjes Civile në Dragash, ku është kërkuar Certifikata e vdekjes për të pandehurin S. R..

Me datë 19.04.2024 Zyra e Gjendjes Civile në Dragash, kësaj gjykate me parashtrësë i ka dorëzuar Certifikatën e Vdekjes me numer rendor 23... dhe numer reference V 10676... meqë rast është konfirmuar se i pandehuri S. R. ka vdekur me dt. 12.10.2022 në Prishtinë.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 158 paragrafi 1 të KPPRK-ës vendosi që t'a hedhë poshtë aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prizren ndaj të pandehurit S. R., për shkak të veprës penale, sulmi nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me par. 1 të KPRK-ës, dhe t'a pushoj procedurën penale, ngase në kuptim të dispozitës së lartcekur vdekja e të pandehurit është rrethanë e cila pengon ndjekjen penale dhe si e tillë e obligon gjykatën që t'a hedhë poshtë aktakuzën dhe të pushojë procedura penale ndaj të pandehurit.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil, në kuptim të nenit 158 par. 2 të KPPRK-ës.

Si u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të aktvendimit e në kuptim të nenit 158 par.1 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË DRAGASH, DIVIZIONI PENAL
2022:078250, 04.12.2024

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Sabaheta Kurteshi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 5 (pesë) ditëve, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.